



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:188128

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724538

C.nr.1144/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Binak Duqi, me procesmbajtësen Fexhrije Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V... I... A..., me nr. personal nga P..., mësimdhënëse ne SHFMU "Z... P..." ne fshatin O... K. P..., të cilin e përfaqësojnë e autorizuar A... K... & A...", me avokatet S... K... etj., rr. "D... e K...", L...U... C.... në P..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "Nuhi Gashi" pn., me objekt kontesti: Kompensim e Kualifikimit/Licencimit dhe Inflacionit me vlerë të kontestit: **3,691.31 Euro**, jashtë seance me dt. 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditëses V... I... A... nga fshati O... K. P..., **si e bazuar**, dhe:

II. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të Kualifikimit/ Licencimit prej 27% me pagën bazë prej 421.00 që t'ia kompensojnë emër të pagës bazë të kualifikimit (nga data 01.01.2022 deri me datë 31.01.2023, kur ka hyrë në fuqi ligji i pagave) sipas pagës bazë prej 421.00 euro për 27%, del të jetë 113.67 euro, apo ($421.00 - 27\% = 113.67$ euro $- 58.32 = 55.35$ euro x 13 muaj = 719.55 euro;

-Refuzohet kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar prej 2.047.95 euro, ngase për të njëjtën çështje është ushtruar padi me herët C.nr.417/2021 nga i autorizuar tjetër dhe kemi për këtë periudhë gjyq varësi (litispedenca), dhe atë (për periudhën prej dt.18.04.2017 deri me dt.22.12.2021), si dhe

- në emër të inflacionit për periudhën shkurt-dhjetor 2021, ka qene $3.4\% \times 421.00 = 14.31$ x 11muaj = 157.45 euro dhe

-në emër të inflacionit për periudhën janar-nëntor 2022, ka qene $10.40\% \times 421.00 = 43.78$ euro x 11=481.62 €.

-Andaj shuma e përgjithshme për inflacion e aprovuar paditësit prej 639.7 euro.

-Gjithsejtë në shumën e aprovuar për kualifikim dhe inflacion paditësit gjykata ia provoj shumën prej $719.55 + 639.7 = 1.359.25$ Euro.

-Përtej shumës së aprovuar shuma tjetër e kërkuar për kualifikim prej 2.047.95 euro dhe shuma prej $215.69 = 2.26263.64$ euro si dhe kamata e kërkuar për inflacion prej 68.42 i refuzohet si e pa

bazuar për shkak të ushtrimit të padisë tjetër më herët nga një i autorizuar tjetër në këtë gjykatë me numrin C.nr. 417/21 për periudhën prej dt.18.04.2017 deri me dt.31.12.2021 dhe kemi të bëjmë për këtë periudhë me gjyq varësi (litispedenca).

III. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, shumat e përcaktuara sikurse në pikën II., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 229.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

IV. DETYROHET paditësja V... I... A... nga fshati O... K. P..., që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 20.00 €, ne llogarinë e gjykatës, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi, nëpërmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi kundër të paditurës për pagesën e Kualifikimit/Licencimit si dhe të Inflacionit, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 03.04.2024, ashtu që ka kërkuar shumën e përgjithshme të cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Ka shtuar se paditësit janë në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura dhe punon si Bibliotekiste. Ne SHFMU “ Z... P... “ ne fshatin O... K. P... Ka theksuar se për periudhën si në kërkesë ka pranuar pagën por jo kompensimin Kualifikimit/ Licencimit si dhe inflacionin sepse në bazë të nenit 7,35 par.5,7 dhe 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit, dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021 nr. 2056 e paditura ka qenë e obliguar që t'ia kompensoi mësimdhënësve tua kompensoj kualifikimin/Licencimin si dhe Inflacionin , mirëpo e njëjta këtë obligim nuk e ka zbatuar, kjo bazuar dhe në nenin 90 par.6 të Ligjit të punës dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin paditësit sipas parashtrësës për plotësimin dhe rregullimin e petiumit të padisë.
Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi me dt. 22.04.2024, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si dhe precizimin e paditësit lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës (diferencës në page sipas nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit (KKA). Ka shtuar se paditësve nuk iu takon kurrfarë diference në pagë, konform koeficientit të paraparë me konkurs për pozitën që ka krijuar marrëdhënie pune. E paditura konsideron se licencimi sipas nenit 7 të kësaj kontrate, nuk ka karakter detyrues për shpërblim të së njëjtës nga pala nënshkruese, këtu e paditura, pasi në këtë nen është përcaktuar mundësia e kualifikimit të mësimdhënësve, e cila rrjedhë sipas legjislacionit të punës dhe legjislacionit për arsim në fuqi, ndërsa nga Ligji i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë Parauniversitar e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë.

Ka theksuar se sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.404/2022 të dt.22.11.2022 ,neni 7 nuk krijon raport obligativ për kompensim, por vetëm detyrim të ngritjes kualitative dhe se çështja e licencimit nuk është përfshirë në pjesën obliguese. Sipas aktgjykimit

të lartcekur neni 7 i KKA në Kosovë nuk ka karakter imperativ dhe si i tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit.

Më tej ka shtuar se paditësit fillimisht është dashur që këtë çështje ta iniciojnë në procedurën administrative dhe më kërkesë ti drejtohet të paditurës, nga shkresat e lëndës shihet se paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme juridike. Po ashtu e paditura i konteston shpenzimet e procedurës për sa i përket precizimit të padisë, ngase precizimi i mëvonshëm i padisë i bërë për shkak se nuk ka qenë e kompletuar padia kur është parashtruar në gjykatë. Po ashtu duhet theksuar se padia e paditësit në këtë rast është në gjyqvarësi me një tjetër te ushtruar me herët në këtë gjykatë dhe mban numrin C. nr.417/2021 dhe është në procedurë.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura për disa vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën për kompensimin e shtesës mujore mbi bazën kualifikimit/licencimit, si dhe te Inflacionit pasi që një gjë e tillë është e obliguar për të paditurën sipas KKA 18.04.2017 dhe 22.01.2021 neni 7 i Kontratës dhe nenit 10 neni 35 par. 5, 7, dhe 10, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Sipas nenit 7 te KKA –se është e parapare që fitohet e drejta në punë, karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit në arsimin në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe ate:”1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë;

1.2 Mësimdhënës me shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% të pagës bazë;

1.3 Mësimdhënës me diplome Fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% te pagës bazë; 1.4 Mësimdhënës me diplome 5 vjeçar, magjistraturës/master dhe doktoraturë 35% te pagës baze dhe 1.5 Përparimet ne karriere, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10%.

Sipas nenit 35 par.10 është e përcaktuar se:’ Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas ESK R. Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit te futet ne page”.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti së kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht nenin 5, 7 dhe 10 te saj.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Kontratën e punës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, nr. ... të datës ..., Diplomës e Kualifikimit nga Kolegji Dardania nr.... dt. , licenca e mësimdhënësit nr. , si dhe Listën e pagave të BRK. lëshuar në emër të paditësit, nga e cila vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar pagën bazë në vlerë prej

421.00 Euro, si provë, e që në këtë rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, kjo dhe duke u bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht neni 7, neni 35 par.5. 7 dhe 10 të saj, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/33 të datës 29.08.2008 dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A-Su.A.214/2023 të datës 05.10.2023.

Përveç, kësaj lartësia e kërkesëpadisë është përcaktuar dhe nga përlllogaritja e palës paditëse-të autorizuarit të tij të cilën e ka bërë në bazë të pagës bazë, siç shihet dhe nga provat e lartcekura dhe atë në shumën e përcaktuar dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Këto përlllogaritje për gjykatën kanë qenë të sakta dhe reale, ngase pala e paditur nuk ka pasur propozime për nxjerrjen e ndonjë prove për vërtetësinë e këtyre përlllogaritjeve, kjo dhe nga fakti se shumtë e kërkuara janë vërtetuar dhe nga listat e pagave dhe një llogaritje e tillë për gjykatën, është llogaritje e thjeshtë matematikore.

Andaj, bazuar në këto përlllogaritje gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësit për periudhën kontestuese, shumën siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i konsideron si të pa pranueshme dhe të pa bazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa-kompensimin në bazë të përgatitjes profesionale (kualifikimit) të paditësit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Ndërsa i mori parasysh kundërshtimet vetëm pjesërisht sa i përket asaj se kemi gjyqvarësi sepse vërtet kemi një padi tjetër që mban nurin C. nr. 417/2021 mirëpo kjo është për një periudhë tjetër dhe atë prej dt. 18.04.2017 deri me dt. 31.12.2021, ndërsa për periudhën e kësaj padie të kërkuar nga pala paditëse nga i autorizuari i saj periudha prej 01.01.2022 deri me dt. 31.01.2023 apo 13 muaj, nuk kemi gjyqvarësi dhe i aprovohet kërkesa e paditëses për këtë periudhë dhe iu refuzuan kundërshtimet e përfaqësuesit të paditurës në këtë drejtim siç është cekur dhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, 104.00 euro për parashtrësën mbi precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë në aspekt objektiv të dt. 03.04.2024 si dhe 21.00 euro takse gjyqësore apo shuma e shpenzimeve prej 229.00 euro, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Vendimi lidhur me detyrimin e paditëses për pagesën e taksës shtesë për padinë e ushtruar në gjykatë, u mor konform dispozitave të nenit 253.1 dhe 4 të LPK-së, si dhe nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke detyruar paditëset që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 20.00 €, në bazë të vlerës së kërkesëpadisë të saktësuar me parashtrësën e datës 03.04.2024, meqë gjykata nuk ka dëshmi se është paguar nga paditëset, ngase me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë është paguar vetëm taksa gjyqësore në shumën prej 20.00 €.

Numri i lëndës: 2022:188128
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05724538

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1144/2022, me datën 22.05.2024**

Gjyqtari:
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.